



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:197723

Datë: 29.01.2024

Numri i dokumentit: 05253204

PPP.nr.890/22

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka në çështjen përmbareme të kreditorit të përbarimit: Inspektorati Farmaceutik me seli në Prishtinë, me adresë ..., ndaj debitorëve të përbarimit: V.E., B.H. dhe M.M. me adresë ..., për kërkesën në të holla objekt i përbarimit, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve të përbarimit të ushtruar kundër urdhërit për caktimin e përbarimit P.nr.143/22 të datës 02.09.2022 të Organit Përmbareme-Përmbaremit Privat M.M., jashtë seance me datë 29.01.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet, prapësimi i debitorëve të përbarimit: V.E., B.H. dhe M.M. me adresë ..., i ushtruar kundër urdhërit për caktimin e përbarimit P.nr.143/22 të datës 02.09.2022, si i pabazuar.

A r s y e t i m i

Organi Përmbareme-Përmbaremit Privat M.M., i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore në P..., duke vepruar sipas propozimit për përbarim të kreditorit të përbarimit, me urdhërin P.nr.143/22 të datës 02.09.2022 e ka caktuar përbarimin në këtë çështje përmbareme në bazë të dokumentit përmbareme-Vendimit të Inspektoratit Farmaceutik Nr.10/LB-012-19 të datës 29.07.2019, pas vlerësimit se përbën bazën juridike dhe titull ekzekutiv për caktimin e përbarimit sipas nenit 21 dhe 22 par.1.2, i

përmbareueshëm sipas nenit 24 par.3 dhe 5, i përshtatshëm për përmbareim sipas nenit 27 par.1 të LPP-së.

Kundër urdhrit mbi caktimin e përmbareimit, brenda afatit ligjor kanë ushtruar prapësim, debitorët e përmbareimit: V.E., B.H. dhe M.M. me adresë

Debitorët e përmbareimit V.E. dhe B.H., me prapësimin e ushtruar, e kanë kundërshtuar në tërësi urdhërin me të cilin është caktuar përmbareimi me arsyetimin se, aktvendimi sipas të cilit është nxjerrë urdhëri përmbareimor është nxjerr në kundërshtim me të drejtën materiale, dhe për këtë arsye kemi filluar edhe procedurë gjyqësore për konstatimit e kundërligjshmërisë së këtij vendimi i cili është objekt i urdhërit përmbareimor. Tutje kanë shtuar se, asnjëra nga bazat ligjore në hyrje të aktvendimit nuk i siguron të drejtën kreditorit të vendos gjobë ndaj debitorëve.

Prandaj bazuar në shkaqet e paraqitura i kanë propozuar gjykatës që të merr aktvendim dhe të pranohet prapësimi si i bazuar dhe të shfuqizohet urdhëri përmbareimor i lëshuar nga përmbareuesi privat.

Debitori i përmbareimit M.M. përmes të autorizuarit të saj ka paraqitur prapësim, duke e konsideruar si tërësisht të pabazuar vendimin e inspektoratit, dhe për këtë arsye me datë 01.10.2019 ka deponuar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë në Departamentin për Çështje Administrative, duke kërkuar që të anulohet vendimin dhe të sjell vendim meritor në këtë çështje kontestuese.

Tutje ka shkruar se, për arsye të cekura më lartë, ka konsideruar se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet ligjore për nxjerrjen e urdhërit për lejimin e përmbareimit nga ana e përmbareuesit, andaj, konform dispozitave të LPP-së ka kërkuar nga gjykata që merr aktvendim dhe prapësimin e debitorit të aprovoj si të bazuar.

Kreditori i përmbareimit nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata, pas shqyrtimit të prapësimit, analizimit të shkresave të lëndës, pretendimet në prapësim, i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se debitori i përmbareimit nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e aktvendimit mbi caktimin e përmbareimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbareimit, të

përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Me nenin 24 par.3 të LPP-së është rregulluar se: Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë, ndërsa me par.5 të njëjtit nen është rregulluar se: Përmbartimi caktohet në bazë të vendimit gjyqësor që ende nuk është bërë i formës së prerë, ose në bazë të vendimit të dhënë në procedurën administrative që nuk është bërë përfundimtar, vetëm po qe se me ligj është paraparë se ankesa apo mjetet tjera juridike, nuk e ndalojnë përmbartimin.

Pretendimi i debitorëve të përmbartimit se ndaj dokumentit përmbartues ka ushtruar padi për fillimin e konfliktit administrativ, gjykata gjithashtu ka vlerësuar se nuk ka mbështetje në ligj ngase, dokumenti përmbartues në bazë të cilit është caktuar përmbartimi në këtë çështje përmbartimore i plotëson të gjitha kushte ligjore për të qenë dokument përmbartues, dhe i njëjti është i pajisur me klauzolën e formës së prerë dhe të përmbartueshmërisë, si dhe bazuar në nenit 22 par.1 të LKA-së me të cilin është e rregulluar se: “Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”.

Gjykata ka analizuar edhe pretendimet tjera të debitorëve të përmbartimit të cekura në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga arsyet e paraqitura, në bazë të nenit 73 të LPP-së, kjo gjykatë ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe të njëjtin e ka refuzuar si të tillë.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.890/22, datë 29.01.2024

Gjyqtari
Përparim Zeka

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.